



| | | | |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Prania / Dorezuar Pembledhje/Prodato Received/Delivered | 05.12.2022 | viti god year | 2 |
| Organ /Nësta Organ /Jednitca Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKUMSHCK | 7680/2022 | | 115 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.539 /2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj dhe Arben Mehmeti-anëtarë, më Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në bazë të Aktgjykimit A.nr.2486/19 të datës 10.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.539/2021 të datës 13.09.2019 të parashtruar nga ankuesi _____ me adrese banimi _____ kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike " *Transferim*", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI ADMINISTRATIV i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.539/2019 të datës 13.09.2029, të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 13.09.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4288/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.04/2019 të datës 22.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datë 26.09.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i _____

Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli, me datë 18.11.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli, me datë 04.10.2019 përmes shkresës me numër protokollit 4665/2019, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e tij të datës 13.09.2019, në mungesë të kuorumit, dhe ka udhëzuar të njëjtin që të ushtroje mjetet tjera juridike në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.2486/2019, ka aprovuar kërkesë padinë e ankuesit, duke e anuluar njoftimin e datës 04.10.2019 dhe ka obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën A.nr.539/2019 të datës 13.09.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numer te protokollit 4288/2019 te datës 13.09.2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Ankesën e datës 05.08.2019 me numër 01/605, drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës: Vendimin me numër KA.nr.04/2019 të datës 22.08.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve: Akt Emërimit me numër të referencës; DS-035-2018 të datës 14.02.2018: Vendimin e datës 30.05.2018 me numër Nr.146/2018: Akt emërimit nen shenjen DBNJ/DSKPK-674/2019 të datës 01.07.2019: Kërkesë për transferim nga pozita drejtor i zyrës për shërbime të përgjithshme në zyrën e prokurorit disiplinor në pozitën drejtor i departamentit të personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës: Emali i datës 24.07.2019 të drejtuar Vendimin me numër të protokollit 01/629 të datës 17.06.2019: Formulari lidhur me përshtkrimin e detyrave të punës të datës 21.11.2017: Kërkesa për përgjigje ne ankese me nuerm te protokollit 4531/20219 të datës 26.09.2019: Përgjigjja në ankesë me numer te protokollit 5411/2022 të datës 18.11.2019; Tabela për përcaktimin e stafit te Zyrës se Prokurës Disiplinore për bartjen në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës: Emali i datës 17.10.2019 te drejtuar Emalin e datës 08.08.2019 të drejtuar Emalin e datës 24.07.2019 te drejtuar Emalin e datës 17.07.2019 drejtuar Njoftimin me numër të protokollit 454/2021 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK të datës 04.02.2021; Njoftimin me numër të protokollit 4665/2019 të datës 04.10.2019; Shkresën me numër të protokollit 3207/2020 të datës 18.12.2020 lidhur me mendimin juridik te avokatit te popullit të datës 10.07.2020; Emalin e datës 16.02.2022 me numër të protokollit 869/2022 lidhur me zbatushmerin e vendimit te KPMSHCK-së.

Kolegji i Këshillit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat e materiale të ndërlidhur me këtë çështje juridike-administrative, ka konstatuar që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.539/2019 të datës 13.09.2019 të ankuesit SEPSE :



Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit me referencë DS-035-2018 të datës 14.02.2018, është emëruar Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Zyrën e Prokurorit Disiplinor në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Siç përcaktohej me nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka nxjerrë Vendimin KPK/Nr.350/2019 të datës 07.06.2019 për transferimin e stafit të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor në njësitë organizative të Administratës së Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shteti dhe po ashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerr vendim KGJK/Nr.132/2019 të datës 12.06.2019 për transferimin e stafit të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor në njësitë organizative të Administratës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatave të Republikës së Kosovës. Në zbatim të këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, përmes Vendimit me numër protokollit DSKPK/219/2019 të datës 19.06.2019, kishte bërë caktimin e tetë zyrtarëve të ish Zyrës së Prokurorit Disiplinor në kuadër të njërive të Sekretariatit të KPK-së, ashtu që ankuesit me datë 01.07.2019 i është ofruar Akt Emërimi DBNJ/DSKPK-674/2019, pa afat, për pozitën e punës Drejtor i Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme në Divizionin për Administratë, me koeficient 17.2 të pagës, e të cilin Akt Emërim ankuesi refuzon ta nënshkruaj, me pretendimin se kjo pozitë nuk është e së njëjtës kategori funksionale dhe gradë të punës me pozitën të cilën e ka ushtruar ankuesi në ish Zyrën e Prokurorit Disiplinor.

Ankuesi i pakënaqur me caktimin e tij në pozitën Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Divizionin për Administratë në Sekretariatit të KPK-së, dhe i pakënaqur me mos përfshirje në listën e të transferuarve nga ana e Sekretariatit të KGJK-së, fillimisht me datë 25.06.2019 ka parashtruar kërkesë me shkrim tek Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, për transferim në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Personelit në kuadër të SKGJK-së, pasi që e njëjta pozitë ishte e lirë dhe ekuivalente me pozitën e tij si Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, me date 24.07.2019, ka informuar ankuesin se nuk ka mundësi ta realizoj kërkesën e tij.

Ankuesi me datën 05.08.2019 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 605 tek Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër përgjigjes se Drejtorit të Përgjithshëm, ndërsa ky i fundit përmes vendimit me numër KA.nr.04/2019 të datës 22.08.2019 është shpallur jo kompetent lidhur me çështjen e ankimore te ankuesit duke e udhëzuar palën që të parashtrroj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e me numër të protokollit 4288/2019 të datës 13.09.2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës pretendon që ti aprovohet ankesa duke i propozuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të detyroj Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës të merr vendim që ankuesin ta caktoj në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Administratës së Përgjithshmen në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësorë.

Ndërlidhur me këtë çështje Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës duke vepruar sipas Aktgjykimit A.nr.2605/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar dhe ka vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.540/2021 të



datës 13.09.2019 të parashtruar nga ankuesi dhe rrjedhimisht ankuesi kishte kërkuar që të aprovet ankesa e tij si e bazuar si dhe të detyrohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, që ankuesin nga pozita Drejtor i Zyrës për Shërbime të Përgjithshme në Divizionin për Administratë në Sekretariatit e KPK-së, ta caktojë në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë në kuadër të SKPK-së, pasi që e njëjta pozitë ishte e lirë dhe ekuivalente me pozitën e tij si Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme dhe me datën 14.01.2022, Këshilli ka nxjerr Vendim me numër A.nr.1188//2018 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit, ka shfuqizuar vendimin KA.Nr.25/2019 të datës 15.08.2019 të Komisionit për Zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe vendimin e me numër protokoll DPSKPK/34/2019 të datës 16.08.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke detyruar organin e punësimit që të bëjë sistemimin në një pozitë ekuivalente të punës sipas Akt Emërimit D-035-2018 të datës 14.02.2018, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës me date 18.02.2022 përmes emailit njofton Këshillin se në zbatim të Vendimit të Këshillit me numër A.nr.1188//2018 të datës 14.01.2022, ka sistemuar ankuesin në pozitën „Udhëheqës i Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke i lëshuar Akt Emërimit me numër DBNJ,DPSKPK-1045/2022 të datës 16.02.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara në lende ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur, në bazë të dispozitës të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, sepse në rastin konkret nga shkresat e lëndës del se objekti i ankesës me numër A.nr.539/2019 respektivisht qëllimi është i njëjti me objektin e ankesës së ankuesit me numër A.nr. 540/2019 të datës 13.09.2019, për të cilën ankesa Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me datën 14.01.2022 përmes Vendimit me numër A.nr.1188/2022, rrjedhimisht Këshilli e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit duke detyruar organin e punësimit që të bëjë sistemimin në një pozitë ekuivalente të punës sipas Akt Emërimit D-035-2018 të datës 14.02.2018, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, ndërsa Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës në zbatim të Vendimit të Këshillit me numër A.nr.1188//2018 të datës 14.01.2022, e ka sistemuar ankuesin në pozitën „Udhëheqës i Departamentit për Burime Njerëzore, Prokurim dhe Administratë në kuadër të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, duke i lëshuar Akt Emërimit me numër DBNJ,DPSKPK-1045/2022 të datës 16.02.2022, pozitë kjo e barasvlershme me pozitën e punës sipas Akt Emërimit D-035-2018 të datës 14.02.2018.

Andaj, nisur nga gjendja faktike si me lartë, respektivisht duke i'u referuar Vendimit të Këshillit me numër A.nr.1188//2018 të datës 14.01.2022 dhe Akt Emërimit me numër DBNJ,DPSKPK-1045/2022 të datës 16.02.2022, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës



respektivisht qëllimi i ankesës së ankuesit me numër A.nr.539/2019 i datës 13.09.2019 është bërë i pamundur - kotë, kështu që në kuptim të nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës së ankuesit me numër A.nr.539/2019 të datës 13.09.2019.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.539/2019

Ilire MEHEMTI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.